

PHILIPS

Radio origjinale

TAVS700



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni mbështetje teknike në
www.philips.com/welcome

Përmbajtja

1	Të rëndësishme	2
	Udhëzime të rëndësishme sigurie.....	2
	Njoftim.....	2
2	Radioja FM/DAB.....	4
	Hyrje.....	4
	Rreth DAB.....	4
	Çfarë ka në kuti.....	4
	Përmbledhje e njësisë kryesore.....	5
3	Fillimi.....	6
	Përgatitja e antenës teleskopike.....	6
	Lidhja me energjinë	6
	Rregullimi i ndriçimit të ekranit	6
	Vendosja e orës	6
	Ndezja	7
	Kalimi në modalitet në pritje.....	7
	Rregullimi i nivelit të volumit.....	7
4	Dëgjimi i radios.....	7
	Dëgjimi i radios DAB.....	7
	Dëgjimi i radios FM.....	8
5	Bluetooth	9
	Luajtja nga një pajisje me Bluetooth.....	9
	Kontrolli i luajtjes	9
6	Veçori të tjera	10
	Vendosja e kronometrit të gjumit.....	10
7	Informacione për produktin	10
8	Zgjidhja e problemeve	11

1 Të rëndësishme

Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Lexojini këto udhëzime.
 - Ruajini këto udhëzime.
 - Përmabajuni të gjitha paralajmërimeve.
 - Ndiqni të gjitha udhëzimet.
 - Mos e përdorni këtë boks pranë ujit.
 - Pastrojeni vetëm me leckë të thatë.
 - Mos bllokoni asnjë vrimë ajrimi.
- Instalojeni sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Mos e instaloni pranë asnjë burimi nxehtësie si për shembull radiatorë, pajisje ngrohjeje, soba, ose bokse të tjera (duke përfshirë amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
 - Mbrojeni kordonin e energjisë në mënyrë që të mos shkelet ose të mos kafshohet padashur te spina, dhe në pikën ku del nga boksi.
 - Përdorni vetëm pjesë dhe aksesore të specifikuar nga prodhuesi.
 - Shkëputeni këtë boks gjatë stuhive me vetëtima ose kur nuk do të përdoret për kohë të gjatë.
 - Drejtojuni personelit të kualifikuar të shërbimit për të gjitha riparimet. Riparimet kërkohen kur boksi është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si për shembull kur kordoni ose spina e energjisë është dëmtuar, janë derdhur lëngje ose kanë rënë objekte brenda boksit, kur boksi është ekspozuar ndaj shiut ose lagështisë, nuk punon normalisht, ose është rrëzuar.
 - Boksi nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
 - Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi boks (p.sh. objekte të mbushura me lëngje, qirinj të ndezur).
 - Përdorni vetëm burimet e energjisë që janë përmendur në këtë manual.
 - Në rastet kur përdoret spina e energjisë ose një bashkues pajisjesh si mjet për ta shkëputur pajisjen, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me

lehtësi.



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij boksi.
- Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të këtij boksi.
- Vendoseni boksën mbi sipërfaqe të sheshtë, të fortë dhe të qëndrueshme.
- Asnjëherë mos e vendosni këtë boks mbi pajisje të tjera elektrike.
- Përdoreni boksën vetëm brenda. Mbajeni boksën larg nga uji, lagështia dhe objektet e mbushura me lëngje.
- Mbajeni këtë boks larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.

Njoftim



Këtu, TP Vision Europe B.V. deklaron se ky boks është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.



Ky boks është ndërtuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Kur bashkëngjitet në produkt ky simbol i koshit me rrota dhe me kryq në një produkt, kjo do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.

Ju lutemi të jeni të informuar lidhur me sistemin e grumbullimit të veçantë në zonën tuaj për produktet elektrike dhe elektronike. Ju lutem veproni në përputhje me rregullat lokale dhe mos i hidhni produktet e vjetra së bashku me mbetjet normale shtëpiake.

Hedhja e produktit të vjetër në mënyrën e duhur do të ndihmojë në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.



Boksi përmban bateri që mbulohen nga direktiva evropiane 2013/56/EU, të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Ju lutem të informoheni për rregullat vendëse lidhur me grumbullimin veçmas të baterive pasi hedhja në mënyrën e duhur do të ndihmojë në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistirol (amortizuesi) dhe polietilen (qeset dhe fletë mbrojtëse sfungjeri). Boksi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohet nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.



Shënim

- Etiketa e të dhënave ndodhet mbrapa boksit.

2 Radioja FM/DAB

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfutur plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni boksën tuaj në www.philips.com/welcome.

Hyrje

Me këtë boks, mund të dëgjoni si radio FM ashtu edhe radio Digital Audio Broadcasting (DAB).

Rreth DAB

Rreth Digital Audio Broadcasting (DAB)

Radioja DAB është një mënyrë e re për të transmetuar radion me anë të një rrjeti transmetuesish tokësorë. U ofron dëgjuesve më shumë mundësi dhe informacion me cilësi zëri të qartë kristal dhe pa zhurma.

- Teknologjia i jep mundësi marrësit që të kapet te sinjali më i fortë që mund të gjejë.
- Me stacionet dixhitale DAB, nuk ka nevojë që të mbani mend frekuencat, dhe zgjedhjet bëhen sipas emrit të të stacionit.

Çfarë është multiplex?

Përdorimi i radios dixhitale bëhet nga një bllok i vetëm frekuencash që quhet multiplex. Secili multiplex punon brenda një spektri frekuece, si për shembull Band III për transmetimet DAB.

TRANSMETUESIT DAB DHE DLS

Çdo transmetues DAB (ose operator multiplex) ofron gjithashtu shërbime informacioni në tekst dhe audio.

Disa programe mbështeten nga Dynamic Label Segments (DLS). Këto janë të dhënat që mund t'i lexoni ndërsa lëvizni tekstin në ekranin e radios DAB. Disa stacione transmetojnë lajmet më të fundit, lajme për udhëtimet dhe motin, çfarë po transmetohet tani dhe çfarë do të transmetohet më pas, adresa faqesh interneti

dhe numra telefoni.



Për më shumë informacion rreth mbulimit dhe shërbimeve të radios dixhitale, ju lutemi vizitoni www.drdb.org.

Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Njësia kryesore
- Kordoni i energjisë AC
- Manuali i përdorimit
- Garancia mbarëbotërore

Përmbledhje e njësies kryesore



1. Çelësi i vogël (majtas)
 - **Shtyp:** Ndizni boksen ose kaloni në modalitetin në pritje
 - **Rrotullo:** Zgjidhni një burim
2. Çelësi i madh (majtas)
 - **Rrotullo:** Zgjidhni një stacion radioje të ruajtur paraprakisht
3. Ekranit
 - Tregoni gjendjen aktuale
4. Çelësi i vogël (djathtas)
 - Shtyp**
 - konfirmo opsionin e menysë
 - në modalitetin DAB/FM ruani stacionet e radios
 - në modalitetin BT, filloni ose ndaloni luajtjen
 - Shtyp dy herë**
 - kthehuni në menynë e mëparshme
 - Mbaj shtypur**
 - hyni në meny
 - Rrotullo**
 - rregulloni volumnin
5. Çelësi i madh (djathtas)
 - Rrotullo**
 - zgjidhni menynë
 - në modalitetin DAB, zgjidhni një stacion DAB
 - në modalitetin FM, shkoni te një stacion FM
 - në modalitetin BT, kaloni te kënga e mëparshme/tjetër
6. AC~
 - Lidhni kordonin e energjisë AC
7. Antena teleskopike
8. 5 V  2 A
 - Për të karikuar pajisje të jashtme

3 Fillimi



Kujdes

- Përdorimi i kontrolleve ose rregullimeve, ose përdorimi i procedurave të performancës përveç atyre që janë specifikuar këtu mund të sjellë rrezatim të rrezikshëm.

Ndiqui gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.

Nëse kontaktoni Philips, do të pyeteni për numrin e modelit dhe të serisë së këtij boks. Numri i modelit dhe i serisë ndodhen mbrapa boksit. Shkruani numrat këtu:

Nr. i modelit _____

Nr. i serisë _____

Përgatitja e antenës teleskopike

Për sinjal optimal, zgjateni plotësisht antenën teleskopike dhe rregulloni drejtimin e saj.



Këshillë

- Pozicionojeni antenën sa më larg të jetë e mundur nga televizori ose nga burimet e tjera të rrezatimit për të parandaluar interferencat.

Lidhja me energjinë




Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është shkruar poshtë produktit.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur shkëputni kordonin e energjisë AC, tërhiqni gjithnjë spinën nga priza. Asnjëherë mos tërhiqni kordonin.
- Përdorni vetëm kordon energjie AC të specifikuar nga prodhuesi ose që shitet bashkë me këtë boks.



Shënim

- Etiketa e të dhënave ndodhet mbrapa boksit.



Lidhjeni prizën AC~ në boks dhe prizën e energjisë në mur me kordonin e energjisë AC.

Rregullimi i ndriçimit të ekranit

- 1 Në modalitetin në pritje, shtypni dhe mbani shtypur çelësin në anën e djathtë për 2 sekonda ose më shumë për të shfaqur menynë.
- 2 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur menynë "DIM".
- 3 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar zgjedhjen tuaj.
- 4 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur nivele të ndryshme të ndriçimit të ekranit.

Vendosja e orës

- 1 Në modalitetin në pritje, mbani shtypur çelësin e vogël në anën e djathtë për 2 sekonda ose më shumë për të shfaqur menynë "CLOCK".
- 2 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar modalitetin e vendosjes së orës. Format i orës [12H] ose [24H] fillon të pulsojë.
- 3 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur [12H] ose [24H].
- 4 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar. Shifrat e orës fillojnë të pulsojnë.
- 5 Përsëritni hapat 3-4 më sipër 3-4 për të vendosur orën dhe minutat.



Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton për 10 sekonda, boksi del automatikisht nga modaliteti i vendosjes së orës.

Sinkronizimi automatik i orës

Nëse ora nuk është vendosur, kur shkoni në një stacion radioje RDS/DAB që transmeton sinjalet e orës, boksi mund të sinkronizohet automatikisht me orën që transmetohet nga stacioni RDS/DAB.

Sinkronizimi manual i orës

Nëse ora është vendosur, kur shkoni në një stacion radioje RDS/DAB që transmeton sinjalet e orës, mund ta sinkronizoni orën manualisht si më poshtë:

- 1 Mbani shtypur çelësin e vogël në anën e djathtë për 2 sekonda ose më shumë për të shfaqur menyën.
- 2 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur menyën "INFO".
- 3 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar zgjedhjen tuaj.
- 4 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur menyën "CT".
- 5 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të sinkronizuar orën.

Ndezja

Shtypni çelësin e vogël në anën e majtë. Boksi kalon në burimin e zgjedhur për herë të fundit.

Kalimi në modalitet në pritje

Shtypni çelësin e vogël në anën e majtë për ta kaluar boksën në modalitet në pritje. Shfaqet ora (nëse është vendosur).

Rregullimi i nivelit të vullmit

Rrotulloni çelësin e vogël në anën e djathtë për të rritur/ulur nivelin e vullmit.

4 Dëgjimi i radios



Shënim

- Sigurohuni që antena është e zgjatur plotësisht.

Dëgjimi i radios DAB

Kalimi në një stacion radioje DAB

- 1 Rrotulloni çelësin e vogël në anën e majtë për të zgjedhur radion DAB.
- 2 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të naviguar nëpër stacionet DAB të disponueshme.

Skanimi i stacioneve të radios DAB

- 1 Mbani shtypur çelësin e vogël në anën e djathtë për dy sekonda ose më shumë për të shfaqur menyën "SCAN".
- 2 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të naviguar nëpër stacionet DAB të disponueshme. Më pas, stacioni i parë i disponueshëm transmetohet.
 - "SCANNING" pulson.

Ruajtja e stacioneve të radios DAB manualisht



Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje DAB.

- 1 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të shkuar në një stacion radioje DAB.
- 2 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të aktivizuar modalitetin e programimit.
- 3 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur një numër të ruajtur.
- 4 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar ruajtjen e stacionit.
- 5 Përsëritni hapat 1 deri në 4 për të ruajtur stacione DAB të tjera.

Shënim

- Nëse boksi shkëputet nga energjia ose ndodh një ndërprerje energjie, stacionet e ruajtura nuk do të fshihen.

Zgjidhni një stacion radioje DAB të ruajtur

Rrotulloni çelësin e madh në anën e majtë për të zgjedhur numrin e ruajtur që doni.

Boksi do të shkojë automatikisht te stacioni i zgjedhur.

Shfaqja e informacioneve DAB

Mund t'i shikoni informacionet e shërbimit DAB në metodat e mëposhtme.

- 1 Mbani shtypur çelësin e vogël në anën e djathtë për 2 sekonda ose më shumë për të shfaqur menyne.
- 2 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur menyne "INFO".
- 3 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar zgjedhjen tuaj.
- 4 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të parë informacionet.
- 5 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të dalë nga pamja e informacioneve.

Lista e informacioneve është si më poshtë:

- Emri i stacionit
- Emri i ansamblit
- Ora
- DLS (Dynamic Label Segment)
- Fuqia e sinjalit
- Lloji i programit
- Frekuenca
- Bit Rate
- Audio

Shënim

- Në varësi të stacionit DAB në të cilin jeni duke shkuar, disa modalitete informacioni mund të mos jenë të disponueshme.

Dëgjimi i radios FM

Kalimi manualisht në një stacion radioje FM

- 1 Rrotulloni çelësin e vogël në anën e majtë për të zgjedhur radion FM.
- 2 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të rregulluar frekuencën FM derisa të gjeni stacionin që doni.

Ruajtja e stacioneve të radios FM

Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje FM.

♦ Automatikisht

- 1 Mbani shtypur çelësin e vogël në anën e djathtë për dy sekonda ose më shumë për të shfaqur menyne "SCAN".
- 2 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të ruan të gjitha stacionet e radios FM. Më pas transmetohet stacioni i parë.
 - "SCANNING" pulson.

♦ Manualisht

- 1 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të shkuar në një stacion radioje FM.
- 2 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të aktivizuar modalitetin e programimit.
- 3 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur një numër të ruajtur.
- 4 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar ruajtjen e stacionit.
- 5 Përsëritni hapat 1 deri në 4 për të ruajtur stacione FM të tjera.

Shënim

- Nëse boksi shkëputet nga energjia ose ndodh një ndërprerje energjie, stacionet e ruajtura nuk do të fshihen.

Zgjidhni një stacion radioje FM të caktuar paraprakisht

Rrotulloni çelësin e madh në anën e majtë për të zgjedhur numrin e ruajtur që doni. Boksi do të shkojë automatikisht te stacioni i zgjedhur.

Shfaqja e informacioneve RDS

RDS (Radio Data System) është një shërbim që u jep mundësi stacioneve FM të shfaqin informacione shtesë.

- 1 Mbani shtypur çelësin e vogël në anën e djathtë për 2 sekonda ose më shumë për të shfaqur menynë.
- 2 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur menynë "INFO".
- 3 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar zgjedhjen tuaj.
- 4 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të parë informacionet.
- 5 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të dalë nga pamja e informacioneve.

Lista e informacioneve është si më poshtë:

- Emri i stacionit
- Lloji i programit, si për shembull [NEWS] (lajme), [SPOR T] (sport), [POP M] (muzikë pop)...
- Ora
- Tekst
- Frekuenca

Shënim

- Në varësi të stacionit RDS në të cilin jeni duke shkuar, disa modalitete informacioni mund të mos jenë të disponueshme.

5 Bluetooth

Luajtja nga një pajisje me Bluetooth

Mund të përcillni audio nga një pajisje te ky boks duke përdorur lidhjen Bluetooth.

Shënim

- Sigurohuni që të aktivizoni Bluetooth për ta bërë pajisjen të zbulueshme para se të bëni çiftimin.
- Boksi dhe pajisja duhet të ndodhen në distancën e pranueshme nga Bluetooth prej jo më shumë se 10 metrash.

- 1 Rrotulloni çelësin e vogël në anën e majtë për të zgjedhur BT. "BT" pulson.
- 2 Në pajisjen Bluetooth, aktivizoni Bluetooth për ta bërë të zbulueshme.
- 3 Zgjidhni "Philips VS700" në pajisje për çiftim.
 - Për një pajisje më të vjetër, vendosni fjalëkalimin e çiftimit 0000.
 - "BT" ndizet kur lidhja bëhet me sukses.
- 4 Shtypni butonin ► në pajisjen Bluetooth për të nisur përcjelljen e muzikës.

Kontrolli i luajtjes

Gjatë luajtjes

- Rrotulloni çelësin e vogël në anën e djathtë për të rritur/ulur volumin.
- Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të luajtur/ndaluar.
- Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të kaluar te kënga e mëparshme/tjetër.

Ndarja e çiftimit me Bluetooth

- 1 Mbani shtypur çelësin e vogël në anën e djathtë për 2 sekonda ose më shumë për të shfaqur menynë "CLEAR BT".
- 2 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar. "BT" pulson.

6 Veçori të tjera

Vendosja e kronometrit të gjumit

Mund ta vendosni boksën që të fiket automatikisht pas një periudhe të caktuar.

- 1 Kur boksë është i ndezur, mbani shtypur çelësin e vogël në anën e djathtë për 2 sekonda ose më shumë për të shfaqur menyën.
- 2 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur menyën "SLEEP".
- 3 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar zgjedhjen tuaj.
- 4 Rrotulloni çelësin e madh në anën e djathtë për të zgjedhur një periudhë kohe të caktuar (në minuta: 15, 30, 45, 60).

Shënim

- Nëse zgjidhet "OFF", kronometri i gjumit nuk do të aktivizohet.

- 5 Shtypni çelësin e vogël në anën e djathtë për të konfirmuar zgjedhjen tuaj. "Z" shfaqet.

7 Informacione për produktin

Informacione të përgjithshme

Kërkesat për energjinë	100-240 V, 50/60 Hz
Konsumi i energjisë	22 W
Përmasat (Gje x La x The)	335 x 185 x 148 mm
Pesha (njësia kryesore)	2,52 kg

Kërkuesi

Rrezja e kërkimit	FM: 87,5 - 108 MHz
-------------------	--------------------

DAB

Rrezja e frekuencave	Band III (174 - 240 MHz)
----------------------	--------------------------

Amplifikuesi

Fuqia output	10 W x 2
Përgjigja e frekuencës	100 - 20000 Hz
Raporti sinjal-zhurmë	> 70 dB

Bokset

Impedanca e boksit	4 Ω
Fuqia input maksimale e boksit	10 W
Drajveri i boksit	3" rreze e plotë

Bluetooth

Versioni i Bluetooth	5.0
Rrezja e frekuencave	2402 - 2480 MHz
Fuqia maksimale e transmetuar	5 dBm
Rrezja maksimale e komunikimit	rreth 10 m
Profilët Bluetooth të pajtueshme	A2DP

Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

8 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij boks.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni boksën vetë.

Nëse hasni probleme ndërsa përdorni boksën, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/welcome). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që boksën është pranë dhe që numri i modelit dhe numri i serisë të jetë i disponueshëm.

Nuk ndizet

- Sigurohuni që kordoni i energjisë AC është lidhur si duhet.
- Sigurohuni që ka energji në prizën AC.

Nuk ka zë

- Rregulloni volumnin.

Nuk ka përgjigje nga boksën

- Lidhni përsëri energjinë AC, dhe pastaj ndizeni përsëri boksën.

Marrje e dobët e sinjalit

- Rritni distancën midis boksit dhe televizorit ose burimit tjetër të rrezatimit.
- Zgjateni plotësisht antenën.

Ora është fshirë

- Është ndërprerë energjia ose kordoni i energjisë AC është shkëputur.
- Vendoseni përsëri orën.

Nuk luhet muzikë në këtë boks edhe pasi lidhja me Bluetooth është bërë me sukses

- Pajisja nuk mund të përdoret për të luajtur muzikë nëpërmjet këtij boksit me anë të valëve.

Cilësia e audios është e dobët pas lidhjes me një pajisje me Bluetooth

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni më shumë boksën ose hiqni çdo pengesë mes tyre.

Nuk lidhem dot me këtë boks

- Pajisja nuk mbështet profilet e nevojshme për këtë boks.
- Funkcioni Bluetooth i këtij boksit nuk është aktivizuar. Shikoni manualin e përdorimit të boksit për të mësuar se si ta aktivizoni funksionin.
- Ky boks nuk është në modalitetin e çiftimit.
- Ky boks është lidhur tashmë me një pajisje tjetër me Bluetooth. Shkëputeni atë pajisje dhe pastaj provoni përsëri.



Philips dhe logoja me mburojën Philips janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. Dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e TP Vision Europe B.V. ose të një prej filialeve të tij, dhe TP Vision Europe B.V. është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

TAVS700_10_UM_V1.0

